



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE
DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
DIREKCIJA ZA ZDRAVSTVO I SOCIJALNU ZAŠTITU



Bazuar në nenin 80.dhe 81.të Ligjit për Zyrtarët Publik,nr.08/L-197,nenin 8. të Ligjit të Punës nr.03/L-21 2,nenin 4.të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017,për rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Aprovimit nga DSHMS, të Propzimit nr.1228,të dt.20/11/2023 të QKMF"Dr.Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë, DSHMS,shpall:

K O N K U R S

Për pranim në mardhënie pune

I.Titulli i vendit të punës:Infermier/e

- Institucioni:Komuna Fushë Kosovë
- Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Lloji i pozitës:Nëpunës i Shërbimit publik
- Numri i Pozitave: 2 (dy)
- Titulli i mbikqyrësit:Kryeinfermierit/eres,Drejtoria të-QKMF-së
- Grada/koeficienti: H20 Koeficienti 5,1 dhe H17 Koeficienti 5,4
- kohëzgjatja e emërimit: Në kohë të pacaktuar
- Vendi i punës: QKMF "Dr.Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Detyrat e punës do t'i kryej sipas Përshkrimit të detyrave të punës në Qarkorën Informative nr.02/2017,aprovuar nga M.SH.-Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm (dt.24/07/2017). Kryen edhe punë të tjera sipas udhëzimeve të udhëheqësit të drejtëpërdrejtë dhe Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës,dhe për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit/eres dhe Shefit të Mjekësisë familjare të QKMF.

Kushtet dhe kriteret:

- të jet shtetas i/e Republikës së Kosovës (kopja e Letërnjoftimit),
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare,në pajtim me Ligjin mbi gjuhët,
- të jetë i/e aftë në pikëpamje shëndetësore (Certifikata e mjekut,pas pranimit në mardhënie pune),
- të mos jet i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (dëshmi me shkrim nga Organi kompetent),
- të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e Zyrtarit publik,
- të ketë të kryer Shkollën e mesme të Mjekësisë,Drejtimi:Infermier/e i/e përgjithshëm/me ose Bachelor i infermierisë (Diploma ose Certifikata-fotokopje),
- personat që kan diplomuar jashtë R.së Kosovës,duhet të kenë të nostrifikuara diplomat në MASHT,
- të jetë i/e regjistruar dhe licencuar në M.SH. (Licenca e punës),

- të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara,
- të ketë shkathtësi pune i/e pavarur dhe në ekip,
- të ketë njohuri të punës me Kompjuterë,
- të ketë kategorinë "B" të vozitjes (e dëshirueshme) dhe
- të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, etnie, religjioni ose race.

Dokumentacioni i nevojshëm

- të ketë të kryer aftësimin adekuat profesional,
- të jetë i regjistruar në M.SH. (liçenca e punës),
- formulari mbi aplikacionin (i plotësuar),
- syzhea personale-CV,
- certifikatë se nuk jeni nën hetime (origjinali),
- dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- certifikata e mjekut (pas përzgjedhjes nga Komisioni).

INFORMATË E PËRGJITHËSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Mënyra dhe afati i aplikimit

Pranimi në detyrë, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. Procesi përzgjedhës do të bazohet gjithashtu në një proces profesional, transparent e të drejtë, bazuar në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, ku përfshihet një testim me shkrim dhe me gojë.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve, është 30 ditë, nga data: 27/11/2023, deri më: 26/12/2023, ditëve të punës, nga ora 08,00 deri në ora 15,00.

Përveç webfaqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës, <http://kk.rks-gov.net/fushëkosovë>.

Aplikacionet merren në Arkivë-QKMF F.Kosovë ose mund të shkarkohet nga web-faqja zyrtare e Komunës së Fushë Kosovës, dhe të plotësuar dorëzohen personalisht në Arkivë ose dërgohen me postë në adresën: QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë, Rruga "Bedri Pejani" p.n..

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakumpletuara nuk do të pranohen.

